

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“DSG HOLDING” L.L.C

Klinë



FABRIKËN E AMBALAZHIMIT TË UJIT “SIBORA”

Investitori: **“DSG HOLDING” LLC**

Adresa : **Gremnikë, Klinë 32000, Kosovë**

Pronar: **Sylejman Gashi**

Klinë, Tetor

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

FABRIKËN E AMBALAZHIMIT TË UJIT NATYRAL DHE MINERAL “SIBORA”

Parcela nr. 0589-1, Zona kadastrale Gremnik, K. Klinë

	Emri		Hartuese e Raportit të VNM-së
Aplikuesi	Sylejman Gashi		Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Investitori:	“DSG HOLDING” LLC		
Adresa:	Gremnikë, Klinë 32000, Kosovë		Glllogoc
Lokacioni i Fabrikës	Gremnikë, Klinë 32000, Kosovë		
Tel:	+377 (0) 44 255 015		+383 49 588 634
Email:	info@dsgholding-ks.com		Blerinabajraktari3@gmail.com

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Datë:16.10.2024

Klinë, Tetor - 2024

Përmbajtja:

1.	HYRJE	1
a)	Vendndodhja e Projektit.....	2
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	4
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit.....	5
d)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit	9
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	11
3.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	11
4.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	12
4.1	Hidrografia	13
4.2	Ndryshimet natyrore.....	14
5.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	14
5.1	Ndikimet në ajër	14
5.2	Ndikimet në tokë	15
5.3	Ndikimet në ujë	15
5.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë.....	16
5.5	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	16
5.6	Ndikimet nga zhurma	16
5.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	16
5.8	Erozioni	16
5.9	Pasuritë Materiale.....	16
5.10	Trashëgimia Kulturore	18
6.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	18
7.	PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	19
8.	PERSHKRIMI I MASAVE.....	22
8.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	22
8.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	22
8.3	Masat për mbrojtje nga zhurma.....	23
8.4	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	23
8.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	23
8.6	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	24

8.7	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	24
8.8	Menaxhimi i mbeturinave	25
9.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	26
10.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	26
11.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	27
12.	LITERATURA E PERDORUR	28
13.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT:	29

Lista e Figurave:

Figura 1	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "DSG Holding" LLC" Sh.p.k.....	2
Figura 2	Lokacioni i Kompanisë "DSG HOLDING" L.L,C. nga komuna e Klinës.....	3
Figura 3	Ortofoto dhe Harta topografike e parcelës ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë	4
Figura 4	Fotot te hangarit të fabrikës për ambalazhimin e ujit “SIBORA” Gremnik Klinë.....	4
Figura 5	Versioni i pare i planifikuar për ujin “SIBORA” për lëshimin ne treg.....	6
Figura 6.	Makinerit për filtrimin e ujit.....	7
Figura 7.	Makineria për dezinfektim	7
Figura 8.	Makina për fryrjen e shisheve	8
Figura 9.	Mkineria për mbushjen e shishave	8
Figura 10.	Makineria për paketim.....	9
Figura 11	Dimensionet e Fabrikës se kompanise DSG HOLDING	12
Figura 12	Rrjeti Hidrografik i Komunës së Klinës	13
Figura 13	Lista e monumenteve te natyrës - trashëgimia natyrore Komuna e Klines	18
Figura 14	Kontejnerët e mbeturinave te ndara.....	26

1. HYRJE

Kompania “**DSG Holding**” LLC me aktivitetin e saj i është bashkuar botës së biznesit së distribuimit qysh në vitin 2001. Falë një ekipi të përkushtuar dhe efikas kompania “**DSG Holding**” hapi qendrën e saj distributive në Gremnik të Klinës. Qysh nga vitin 2001 Kompania jonë ka shënuar rritje të suksesit në biznes duke krijuar bashkëpunime të mirëfillta me partnerët tanë tregtarë. Tani, **DSG Holding** numëron mbi 30 të punësuar, të cilët janë pjesë e ekipit tonë profesional. Kompania “**DSG Holding**” posedon pajisje moderne kompjuterike për aktivitete dinamike dhe cilësore, si dhe automjetet bashkëkohore për distribuimin sa më të shpejt të mallrave deri te konsumatori. Përformancat tona afariste zhvillohen nga qendra jonë e distribuimit e cila ka një ambient shumë të sofistikuar dhe të përshtatshëm biznesor.



“**DSG Holding**” LLC konkretisht bën prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve nëpër të gjitha qytetet e Kosovës dhe të rajonit. Ne prodhojmë, distribuojmë dhe shesim produktet finale në gjithë Kosovën, Objektivi kryesor i punës sonë është shpërndarja e mallrave me konsumim të gjerë nëpërmjet qendrës sonë distributive dhe organizimit profesional të sektorit tonë të shitjes. Duke parë që kërkesat për ujë të pastër dhe të shëndetshëm çdo ditë sa vine e shtohen kompania ka analizuar dhe ka filluar me vendosjen e linjës së re për ambalazhimin e ujit.

Tani Kompania “**DSG Holding**” LLC ka filluar kompletimin e dokumentacioneve të nevojshme për hapjen e fabrikës për ambalazhimin e ujit natyral dhe mineral “**Sibora**” i cili parashihet të jete njeri ndër ujërat më cilësore në vend.

“**DSG Holding**” pritet të vazhdojë të mbajë lart cilësinë e prodhimit të “**Siborës**”. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe Kompania ka zgjeruar rrjetin e vet të distribuimit duke krijuar partneritet me kompani mjaft të suksesshme.

Uji “**Sibora**” thekson gjithashtu përkushtimin e tij ndaj qëndrueshmërisë, me fokus në paketimin miqësor ndaj mjedisit dhe praktikave të burimit.

Mesazhet për ujin “**Sibora**” fokusohen në përfitimet e pirjes së ujit të pastër për shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme. Marka pozicionohet si një burim uji i besueshëm dhe premium që është i lirë nga papastërtitë dhe ndotësit.

Në përgjithësi, marka **Sibora** është krijuar për të tërhequr konsumatorët e ndërgjegjshëm për shëndetin, të cilët vlerësojnë ujin e pastër dhe freskues dhe janë në kërkim të një marke uji premium që përputhet me vlerat e tyre. Psikologjia e këtij dizajni unik që asnjë nga konkurrentët nuk e ka aktualisht është krijimi i një sistemi jetese.

Kështu edhe të rinjtë mund të shijojnë përvojën e markës që ne po përpiqemi të japim, gjithashtu krijimi i etiketave ndihmon çdo moshë që t'i kushtojë vëmendje produktit në tërësi.

Kompania **“DSG Holding” LLC** ndodhet në fshatin Gremnik të Komunës së Klinës, me lokacion në ngastrën kadastrale nr. 00589-1.

Kompania dëshiron që të pajiset me Pëlqim Mjedisor dhe për këtë ka angazhuar personin fizik të licencuar për VNM dhe ka filluar përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis për Fabrikën e ambalazhimit të ujit.

Ky raport është hartuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 4, sipas të cilit është kërkuar edhe nga ana e Inspektoratit Mjedisor nga MMPHI.

Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis.

a) Vendndodhja e Projektit

Objekti i Fabrikës së Ambalazhimit të ujit “Sibora” ndodhet në ngastrën me nr. 00589-1, Zona kadastrale Gremnik Komuna e Klinës. Kompania **“DSG Holding” LLC** ndodhet në territorin administrativ të komunës Klinës afër rrugës Kline - Gjakovë.




Figura 1 Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "DSG Holding" LLC" Sh.p.k.

Lokacioni ku është e ndërtuar fabrika për Ambalazhimin e Ujit “SIBORA” ka qene e ndërtuar e cila është përdorur si depo për ruajtjen e produkteve tjera, atëherë kompania ka porositur një linje të ambalazhimit të ujit që në fillim të këtij një kapacitet të vogël të prodhimit dhe pastaj në rast se ky biznes lulëzon atëherë edhe kompania pritet që dale ngadalë të rrit kapacitetin e prodhimit por edhe të fuqisë punëtore, gjithashtu kompania në fjale është e interesuar që të mos ketë probleme me inspektoratin mjedisor nga MMPHI.




Figura 2 Lokacioni i Kompanisë "DSG HOLDING" L.L.C. nga komuna e Klinës



Figura 3 Ortofoto dhe Harta topografike e parcelës ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Duke u bazuar në atë se objekti i fabrikës së ambalazhimit të ujit ka qene i ndërtuar, i cili është përdorur për magazinimin e pijeve tjera për te cilat kompania “DSG HOLDING” LLC është distruburore e autorizuar siç janë, birra e Pejës, Vera si dhe aloe vera, dhe tani edhe me prodhimin e ujit “Sibora” është pare se Operimi dhe mirëmbajtja nuk kane kosto te larte dhe se nuk ndikojnë ne ambient, për arsye se objekti ka qene i ndërtuar ne atë zone i cili është e dedikuar për këtë lloj veprimtarie. Objekti i fabrikës ka një sipërfaqe prej 830 m² me te gjitha objektet tjera. Objekti i kompanisë është i ndërtuar: baza e themelit me beton arme, muret jane te ndërtuara nga bllokat giter, ndërsa kulmi me konstruksion montazh nga konstruksioni i çelikut.



Figura 4 Fotot te hangarit të fabrikës për ambalazhimin e ujit “SIBORA” Gremnik Klinë.

Shihet qarte se fabrika është e ndërtuar sipas normave dhe standardeve e cila ka hapësira gjelbëruese për rreth objektit dhe po ashtu rrugët janë te projektuara sipas normave dhe standardeve që të mos kemi bllokim dhe vonesa në oborrin e kompanisë po ashtu kompania ka ndërtuar edhe parkingjet për klient para objektit.

Veprimtaria e ambalazhimit të ujit, vlerësohet se do të ketë ndikimin minimal në mjedis.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Fabrika për ambalazhimin e ujit “Sibora”, pritet të operoj nga viti 2023.

Me poshtë paraqesim përshkrimin e aktivitetit të Fabrikës për ambalazhim të ujit me objekte shoqëruese të nevojshme që janë ndërtuar dhe do të instalohen për këtë aktivitet:

Elementet kryesore të linjës për pastrimin dhe mbushjen e ujit janë:

- instalim për filtrim;
- rezervuar për ujë të pastruar;
- kompleksi i shisheve;
- enë.

Para hyrjes në rezervuar, në impiantin e filtrimit përfundojnë disa faza të pastrimit. Blerja e filtrave kryhet pasi uji ka kaluar një sërë analizash Epidemiologjisë. Bazuar në përfundimin e analizës, zgjidhen parametrat dhe numri i filtrave. Nga kjo varet edhe kostoja përfundimtare e linjës.

Sa i përket komponentëve kryesore, për ambalazhimin e ujit janë:

- Lënda e pare është uji,
- Energjia elektrike,
- Eprovetat

Duke u fokusuar në këto fusha kyçe, DSG HOLDING beson se mund të arrijë vizionin për shkallëzimin e shitjeve dhe përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të produkteve të kompanisë, paketimit, transportit dhe shërbimit ndaj klientit.

Zhvillimi i produktit: Kompania do të investojë në kërkime dhe zhvillim për të përmirësuar cilësinë dhe funksionalitetin e produkteve të sajë. Ne gjithashtu do të qëndrojmë të përditësuar me tendencat e industrisë dhe reagimet e klientëve për të siguruar që po plotësojmë nevojat e klientëve të sajë.

Paketimi dhe transporti: Do të investojë në metoda më të mira paketimi dhe transporti për të siguruar që produktet të arrijnë në destinacionin e tyre në gjendje të përsosur.

Shitjet: Do të rrisin përpjekjet për shitje përmes fushatave të marketingut të synuar, ndërtimit të marrëdhënieve me partnerët kryesorë dhe zgjerimit të rrjetit tonë të shpërndarjes.

Shërbimi ndaj klientit: Do të ofrojë shërbim të shkëlqyer ndaj klientit duke qenë të përgjegjshëm dhe duke ofruar komunikim të qartë, gjithashtu do të trajnojnë stafin për t'u siguruar që ata kanë njohuri për produktet dhe mund të ofrojnë këshilla të dobishme për klientët. Produktet të cilat prodhohen nga kompania "DSG Holding" LLC, janë:

Për momentin kompania ka planifikuar vetëm versionin e shishes se me poshtme:



Figura 5 Versioni i pare i planifikuar për ujin "SIBORA" për lëshimin ne treg

Sa i përket biodiversitetit në atë lokacion nuk është shumë i zhvilluar për arsye se zona ka fabrika dhe industri e po ashtu në afërsi gjendet edhe rruga Kline – Gjakove nga e cila krijohen zhurma që lëvizin në atë lokacion dhe nuk është dhe aq i zhvilluar.

d) Procesi teknologjik

Kompania "DSG HOLDING" L.L.C. do të merret me prodhimin dhe ambalazhimin e ujit të pijshëm. Më poshtë është përshkrimi i detajuar i çdo faze.

Prodhimi i ujit të pijshëm përfshin disa procese teknologjike që sigurojnë që uji të jetë i sigurt për konsum dhe i pastër. Ja një përmbledhje e detajuar e hapave kryesorë:

Burimi i Ujit - Uji mund të merret nga burimi ujorë ku I bëhen analizat kimike dhe mikrobiologjike për të identifikuar ndotësit si metalet e rënda, pesticidet, bakteriet dhe kimikatet e tjera. Kjo siguron që burimi të përmbushë standartet e sigurisë.

Marrja dhe Transporti – pompat përdoren për të nxjerrë ujin nga burimi dhe për ta transportuar në fabrikë. Pompat janë të dizajnuar për të menxhuar volumin e madh të ujit dhe për të siguruar presionin e nevojshëm. Sistemi i tubacioneve siguron transportin e ujit në mënyrë efikase dhe të sigurt, duke minimizuar humbjet.

Filtrimi:

- **Filtrimi mekanik:** Përdoren filtra me rrjetë të trashë për të hequr grimcat e mëdha, si rëra dhe mbeturinat.
- **Filtri me karbon aktiv:** Heq kimikate të dëmshme si klor, pesticide, dhe përmirëson shijen dhe aromën e ujit.




Figura 6. Makinerit për filtrimin e ujit

Dezinfektimi - bëhet duke shtuar klorin për të eliminuar patogjenët dhe bakteriet. Kjo është një metodë standard për singurinë e ujit



Figura 7. Makineria për dezinfektim

Rregullimi i pH dhe Mineralizimi – Për pH përdoren substance si acidet ose alkalinet për të siguruar që pH të jetë në nivelet e rekomanduara (zakonisht mbi 6.5 dhe 8.5). Ndërsa mineralizimin bëhet duke shtuar minerale esenciale si kalciumi dhe magnezi për të përmirësuar shijen dhe përfitimet për shëndet.

Fryrja e Shishave – shishet pastohen me ujë të nxehtë dhe kimikate për të hequr çdo mbetje të mundshme. Kjo është një faze e rëndësishme për të sigurin e produktit, pas larjes shishet ftohen për të përgatitur për mbushje, duke ndihmuar në eliminimin e lagështisë.



Figura 8. Makina për fryrjen e shisheve

Mbushja dhe Paketimi - Uji mbushet automatikisht në shishe, me sisteme që monitorojnë saktësinë e sasisë. Kjo ndihmon në reduktimin e humbjeve. Shishet e mbushura grupohen dhe paketojnë në kartona ose paketa për shpërndarje.



Figura 9. Mkineria për mbushjen e shishave



Figura 10. Makineria për paketim

Etikimi- Ato aplikojnë etiketa në shishet me informacionin për produktin, përfshirë datën e skadencës dhe informacionin mbi përbërësit. Sistemet e skanimit shërbejnë për të kontrolluar saktësinë e etiketave dhe përputhshmërinë me rregulloret.

Kontrolli i Cilësisë - Kryhen analiza të rregullta për të kontrolluar për kontaminantë dhe për të siguruar përputhshmërinë me standardet e sigurisë. Siguron që çdo shishe është mbushur me sasinë e duhur të ujit.

Distribucioni - Uji i paketuar transportohet në dyqane dhe pika shitjeje. Kjo përfshin planifikimin e shpërndarjes dhe menaxhimin e stokut për të siguruar që produktet mbërrijnë në kohë.

Ky proces i plotë siguron që uji të jetë i sigurt, i pastër dhe i gatshëm për konsum, duke ndjekur standardet e larta të cilësisë dhe sigurisë.

e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së ndërtimit dhe operimit

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha emetimet e pritura gjate fazës së ndërtimit dhe gjate operimit:

- **Uji** – Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës nuk ka ndikuar negativisht gjate fazës së ndërtimit por nuk do të ndikoj negativisht as gjate fazës së operimit, ndotja është minimale. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për proces teknologjik të ambalazhimit të ujit dhe për nevoja sanitare dhe higjienike dhe nuk përdoret për qëllime tjera. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për nevoja sanitare pas

përdorimit të tij do të shkarkohet në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Ndikimi kryesor i ndotjes së ujërave janë shkarkimet e ujërave të pa trajtuara në mungesë të impianteve.

- **Ajri** - nga ky aktivitet nuk ka pasur dhe priten ndikime të theksuara në ajrin ambiental. Ky aktivitet nuk parasheh përdorimin e lëndëve djegëse të dëmshme, nuk parasheh ndonjë proces teknologjik të përpunimit të produkteve industriale apo kimike dhe realisht nuk paraqet potencial për ndikime në kualitetin e ajrit. Ndikime minimale kanë ndodhur gjatë fazës së ndërtimit: Në kualitetin e ajrit brenda parcelës së ndërtimit, gjatë sjelljes së materialeve të parafabrikuara me kamion.
- **Dheu** – duke konsideruar kapacitetet e projektuara të fabrikës së ambalazhimit të ujit - mbushtores, si dhe si rezultat i investimit adekuat – kontakti i ujërave nga brenda lokacionit të projektit me ujërat sipërfaqësore është izoluar - mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën dheut janë minimale, duke pasqyruar edhe aktivitetin e punës.
- **Zhurma** – gjatë ndërtimit e po ashtu edhe gjatë operimit nuk ka zhurmë, zhurma si gjatë ndërtimit e po ashtu edhe gjatë operimit është minimale, zhurma më e madhe mund të vijë si pasojë e lëvizjeve të makinerive në rrugën kryesore afër fabrikës.
- **Dridhjet** – Dridhjet e tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasojë në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim. Dukuritë tjera, që shpesh ndodhin në territorin e Klina, janë: rrëshqitja e dheut, akullnajat, breshëri, si dhe dukuritë tjera që shkaktojnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.
- **Drita, nxehtësia dhe rrezatimi** – Janë tri dukuri që të trija bashku të ndihmojnë në realizimin e punës ku Lokacioni ku është ndërtuar fabrika ka dritë, rrezatim diellor dhe nxehtësi të mirë.
- **Flora dhe Fauna** – Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë.
- **Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqesë ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku shumë qytetar do të punësohen dhe do të përfitojnë paga dhe mëditje të mira. Ky do të ndikojë pozitivisht në ekonominë lokale dhe qendrore.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e fabrikës së ambalazhimit të ujit- mbushtores dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), Fabrika apo hangari edhe ndërtuar për distribuimin e pijeve alkoolike dhe jo alkoolike dhe pastaj në fund të vitit 2022 ka lindë ideja për ambalazhimin e ujit, i cili tani është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME

Duke e pasur parasysh se hapësira ku është ndërtuar fabrika e ambalazhimit të ujit, ka hapësirë të mjaftueshme edhe për vendosjen e fabrikës së mbushtores mesatare e cila është përzgjedhur në atë mënyrë që të kemi hapësirë të madhe të hangarit për të operuar dhe zhvilluar punën në mënyrë të lirshme, po ashtu edhe teknologjia ta mundëson që hapësira brenda fabrikës të jetë me e madhe për futjen e makinerive të ndryshme si dhe në rast të prishjes së tyre me lehtë të nxirren jashtë nëse është e nevojshme.

Teknologjia e përdorur është e qëndrueshme me çmime mesatare jo të lart te cilat kryejnë funksionin shumë mire.

Përzgjedhja e këtyre dimensioneve të fabrikës kanë qene e kushtëzuar edhe nga parcela, rrugët, instalimet e ujit dhe kanalizimit të cilat kane qene te përfunduara para se te filloj ndërtimi i fabrikës. Dimensionet e fabrikës janë: B = 18.45 metra gjerësi dhe L = 47.50 metra gjatësi ne figurën e mëposhtme.



Figura 11 Dimensionet e Fabrikës se kompanise DSG HOLDING

Ndërsa sa i përket efekteve mjedisore ky objekt nuk ka ndikuar fare ne mjedis sepse aty edhe para ngritjes se fabrikës ka pasur ndërtime te objekteve tjera e cila ka qene dhe është zone.

4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Te dhënat e mëposhtme i përkasin gjendjes se tanishme mjedisore ne komunën e Klinës. Qëllimi kryesor i te dhënave baze është te identifikojë gjendjen mjedisore ne ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara te zhvillimit dhe implementimit te hartës zonale komunale te komunës se Klinës ne lidhje me investimin e propozuar. Impaktet potenciale te zhvillimit te mund te vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e dokumentit nëpërmjet indikatorëve te gjendur-te supozuar sasiore ose cilësore. Esencialisht, gjendja mjedisore e komunës se Klinës karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisore. Siç kërkohet nga direktiva e VNM-se. Te përbashkuara me poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrore;
- Cilësia e ajrit
- Bezdisjet
- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët klimatikë, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peizazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

4.1 Hidrografia

Resurset kryesore të ujërave sipërfaqësore ne komunën e Klinës janë 3 lumenjtë kryesor si: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës dhe lumi Klina. Shtrihet në një territor kryesisht rrafshinor me lartësi mbidetare prej 349-435m.




Figura 12 Rrjeti Hidrografik i Komunës së Klinës

4.2 Ndryshimet natyrore

Normal qe me ndërtimin e fabrikave te ndryshme do te kemi edhe prishje te peizazhit, do te kemi ndotje gjate ndërtimit ne suaza te caktuara si dhe do te ketë ndryshim te atij lokacioni, sepse shtohet një ndërtim i ri ku kemi me shume ndotje nga shkarkimi i ujerave te kanalizimit, po ashtu lëvizjet e makinerive përreth objektit, gazrat ose pikja e vajit ne raste te ndonjë prishje, ku këto janë te gjitha shkaktar qe mund ta ndryshojnë mjedisin.

Vlen te theksohet se edhe mbeturinat komunale bëjnë ndotje te madhe ne ambient dhe natyrë. Sa i përket projektit te fabrikës për ambalazhimin e ujit, nuk ka fare ndikim ne ambient sepse nuk shkarkohen ndonjë kemikat apo ndonjë substance qe mund te ndotë ujin apo dheun, po ashtu nga funksionimi i fabrikës nuk lirohen gazra.

Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial, mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve, vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit dhe ujit, zhurma).

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në Fabrikën e ambalazhimit te ujit-mbushtoren e kompanisë “DGS HOLDING” LLC, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte që do të ofroj si dhe për mundësitë e punësimit. Ndikimet në mjedis vinë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse qe do të përdoren për te eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin konceptual të diskutuar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është duke funksionuar si pike distribuimi për produkte tjera ndërsa tani pritët ti shtohet edhe linja e ambalazhimit te ujit “SIBORA”. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

5.1 Ndikimet në ajër

Ndotja e ajrit në Kline shkaktohet kryesisht nga transportit rrugor dhe hekurudhor. . Përdorimi I automjeteve private është rritur në mënyrë dramatike kohët e fundit e sidomos pas luftës. Kjo

formë e transportit është njëri ndër ndotësit kryesor të ambientit. Gjithashtu edhe gurëthyesit në këtë rajon ndikojnë negativisht në ajër në rastet kur nuk kontrollohen pluhurat.

5.2 Ndikimet në tokë

Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë fabrike nuk do të kenë ndikim të madh në tokë, prapëseprapë në lokacionin ku është ndërtuar fabrika, nuk është bërë ndonjë aktivitet i cili do të kishte dëme të theksuara në dëmtimin fizik të tokës. Nga shkarkimi i ujerave pas procesit të ambalazhimit dhe pastrimit të makinerive nuk do të ndodhë ndotja e tokës pasi mbushitorja, e DSG HOLDING ujerat që shkarkohen nuk kanë nivel të lartë të ndotjes dhe ato shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Ndërsa ndikime tjera si derdhje e vajrave etj, nuk ka.

5.3 Ndikimet në ujë

Në këtë zonë gjenden pak burime ujore dhe trupa ujorë që mund të preken nga ndërtimi i këtij projekti. Vetë projekti do të kujdeset për të përmirësuar menaxhimin e këtyre ujërave, kryesisht të ujërave nëntokësorë. Materialet dhe arkitektura që do të përdoren në këtë projekt do të jenë të favorshme për mjedisin. Punët e ndërtimit për fabrikën e ambalazhimit të ujit nuk ndikojnë në burimet ujore të së gjithë zonës së projektit. Masat lehtësuese përfshijnë Praktikën më të mirë të menaxhimit të ndërtimit, e cila do të jetë një nga kërkesat bazë të specifikimeve të kontratës. Ndikimet gjatë fazës së ndërtimit (vetëm në rastet aksidentale) përbëhen nga:

- Përkeqësimi i cilësisë së ujit për shkak të punëve të ndërtimit;
- Shkarkimi aksidental i hidrokarbureve nga automjetet e transportit dhe të punës. Të dyja këto ndikime të mundshme prekin të gjithë trupat ujorë që ndërpresin projektin.
- Lumi Drini i Bardhë Sipas projektit, nuk do të ketë asnjë ndërprerje të projektit me këto trupave ujorë.
- Gjatë ndërtimit nuk do të ketë asnjë ndikim në cilësinë e vetë ujit, duke marrë parasysh që punimet do të jenë sipërfaqësore me materiale natyrore, ekologjike të zonës përreth.
- Ndikimi gjatë fazës operacionale të vënies në funksion të projektit pritet të jetë I vogël nëse merren masat e duhura.
- Ndikimet mund të vijnë si pasojë e Derdhjeve aksidentale të hidrokarbureve gjatë lëvizjes së makinave.
- Ndikimet e mundshme në burimet ujore mund të shfaqen për shkak të incidenteve që lidhen me shkarkimet aksidentale të karburantit, naftës dhe kimikateve të rrezikshme, ruajtjen dhe trajtimin e gabuar të mbetjeve.

5.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Aktiviteti i punës së kompanisë në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë.

5.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku gjendet fabrika e lartpërmendur nuk ka ndikim negative në popullatën e zonës. Pasi që lokacioni ku është duke vepruar fabrika për ambalazhimin e ujit, është e ndërtuar para shume shtëpive që gjenden në afërsi të asaj zone dhe se nuk krijon shqetësim për banorët lokal. Në të kundërtën, ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal në këtë fabrikë.

5.6 Ndikimet nga zhurma

Si rezultat i natyrës së veprimtarisë së ushtruar në këtë fabrikë nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin për rreth, e cila do të shqetësonte banorët e kësaj zone. Fabrika e mbushtores pritet të punoj vetëm me një ndërrim të rregullt prej 8 orë/pune, prandaj kjo është edhe e favorshme për fabrikën në lidhje me zhurmën, pasi në këtë orar qytetaret janë aktiv thuaj se të gjithë dhe zhurma është edhe me pak e ndjeshme.

5.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve nga fabrika për ambalazhimin e ujit DSG HOLDING, vlerësohen si raste të izoluar. Nuk ka aktivitete me materie të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi.

5.8 Erozioni

Erozioni mund të shkaktohet si nga thatesirat me temperatura të larta ku kemi qarje të tokës e po ashtu edhe nga vërshimet ku kemi rrëyerje të tokës.

Dridhjet të tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkakuar vetëm shqetësim. Dukuritë tjera, që shpesh ndodhin në territorin e Komunes së Klines janë: rrëshqitja e dheut, akullnajat, breshëri, si dhe dukuritë tjera që shkaktojnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.

5.9 Pasuritë Materiale

Në zonën e studiuar janë zhvilluar formacionet gjeologjike të mëposhtme:

- a) Depozitat kuaternare;
- b) Shkëmbinjtë sedimentarë të Pliocenit të poshtëm-Sipërm (Np1-Np2).

Depozitat kuaternare (aQh-dQh) Këto depozita kanë ndërtuar disa vende të zonës ku janë realizuar investigimet. Ato përfaqësohen nga depozitat deluviale (dQh) dhe aluviale (aQh), të cilat janë pluhura me një përzierje zhavorresh, rëra dhe pluhura. Këto depozitime kanë formuar një trashësie nga 0.7- 1.5m deri në 3.5-4.0m.

Shkëmbinjtë sedimentarë të Pliocenit të poshtëm-Sipërm (Np1-Np2) Shkëmbinjtë sedimentarë të formacioneve të Pliocenit të Poshtëm-Sipërm (Np1-Np2) ndodhen në pjesën qendrore të zonës së studiuar. Ato shtrihen në veriperëndim në juglindje me kënd të zhytjes në drejtimin verilindor dhe këndin e pjerrësisë 20° -30°. Ato përbëhen nga shkëmbinj argjilore-ranore të cilat lidhen me shtresa të holla të shkëmbinjve të formuar nga sedimentet pluhurorë, të cilat lidhen me vetitë gjeoteknike të përfshira në shkëmbinjtë e butë. Ky formacion në pjesën e sipërme të profilit litologjik karakterizohet nga korja e përarruar e cila ka një trashësi nga 1.5-2m deri në 3-4m. Shumica e këtyre shkëmbinjve janë të mbuluar nga depozitat Kuaternare të cilat përbëhen nga suargjilat, argjila me përmbajtje ranore etj. Depozitat Kuaternare kanë një trashësi që varion nga 0.7-1.5m deri në 3.5-4.0m. Zona e studiuar gjatë periudhave të reshjeve dhe stuhive sipas dukurive gjeodinamike (rrëshqitjeve të tokës dhe erozionit) është aktive.

Dukuritë gjeodinamike - Në zonën e studiuar gjenden dukuri gjeodinamike, të cilat janë dy Rrëshqitje. Nga vëzhgimi ynë në terren mbi shkëmbinjtë sedimentarë, në të dy anët e luginës së lumit Drini i Bardhë gjenden rrëshqitjet e tokës, të cilat zakonisht janë të cekëta (1.0-3.0m). Këto rrëshqitje të tokës janë aktive. Ata janë në lëvizje gjatë periudhës së reshjeve.

5.4.3.Karakteristikat gjeoteknike Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i karakteristikave gjeoteknike të sheshit të ndërtimit. Bazuar në projektin i cili ishte planifikuar për ndërtim, në zonën e studiuar u përcaktuan zonat e mëposhtme gjeoteknike. Dhera me kohezion; Pjesa e sipërme e prerjes litologjike të zonës së studiuar përfaqësohet nga dhera diluviale dhe proluviale, të cilat janë përzierje inorganike të pluhurave me rërë dhe mbeturina rrënojash, ngjyrë kafe, përmbajtje të ulët uji dhe me konsistencë të ngurtë deri në shumë të ngurtë. Kjo shtresë ndodhet mbi shkëmbinj dhe ka një trashësi që varion nga 0.7-1.5m deri në 3.5-4.0m. Dhera pa kohezion; Përfaqësohet nga dhera aluviale, të cilat janë përzierje zhavorresh, rërash dhe pluhura. Ky lloj dheu është në një konsistencë në gjendje mesatare deri të lirshme. Shkëmbinj të butë; Përfaqësohen nga shkëmbinjtë sedimentarë të Pliocenit të Poshtëm-Sipërm (Np1-Np2). Këta shkëmbinj përbëhen nga shkëmbinj ranorë-argjilorë të ndërlidhur me shtresa të holla shkëmbinjsh të ndërtuar nga dherat pluhurorë

5.10 Trashëgimia Kulturore

Me poshtë do te paraqesim listën me trashëgimitë natyrore ne komunën e Klinës, ku asnjëra nga këto nuk gjendet afër fabrikës se ambalazhimit te ujit.

Figura 13 Lista e monumenteve te natyrës - trashëgimia natyrore Komuna e Klinës

Emërtimi i Zonës/objektit	Komuna	Sipërfaqja në ha	Viti mbrojtjes	Kategoria ne Kosove	Kategoria IUCN	Përshkrimi shkurtër i vlerave
III. MONUMENTET E NATYRËS						
Rrjedha e lumit Mirusha	Malishevë, Klinë	10,03,35 1,93,94	1983		III	Rëndësi hidrologjike dhe peisazhore
Burimi i ujit mineral në Dresnik	Klinë	6,75	1985		III	Monument natyror me karakter hidrologjik
Gryka e lumit Klina	Klinë	1,204,94,49	1985		III	Monument kompleks i natyrës me vlera geomorfologjike, hidrologjike dhe botanike
Trungu i qarrit në Zllakuqan (Quercus cerris)	Klinë		1985			Monument natyror me karakter botanik dhe turistik
Trungu i qarrit në Poterq të ulët (Quercus sp.)	Klinë		1985			Ish monument natyror me karakter botanik
Trungu i vidhit në Qabiq (Ulmus minor Miller)	Klinë		1985			Ish monument natyror me karakter botanik
Trungu i qarrit në Bërkovë (Quercus sp.)	Klinë		1985			Ish monument natyror me karakter botanik
PEIZAZHET E MBROJTURA						
Parku regional i Mirushës	Klinë, Malishevë, Rahovec	555,80,70	1982,1983		V	Kanioni me ujëvarat e njëpasnjëshme dhe peizazhet specifike, paraqet një fenomen të rrallë natyror që ka rëndësi të jashtëzakonshme natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike

6. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

- Ndërtimi dhe Ekzistenca e projektit deri me tani nuk ka shkaktuar ndonjë ndikim ne mjedis apo pasoje. Duke u bazuar ne atë se projekti është i natyrës se përhershme, kompania nuk mendfonta demoloj por ne raste se ndodh nuk do te kemi pasoja shume te renda për arsye se projekti është i tipit montazh dhe shume lehte mund te demolohet.
- Për ndërtimin e objektit, është shfrytëzuar sipërfaqja e tokës e po ashtu është shfrytëzuar energjia dhe uji te cilat janë te nevojshëme gjate ndërtimit e po ashtu edhe pas ndërtimit. Sa i përket ndikimeve përpos qe ka ndikua ne nxënien e sipërfaqes se tokës ndonjë ndikim tjetër nuk ka pasur.
- Në fabrikën për ambalazhimit të ujit “DSG HOLDING” L.L.C nuk emetim te zhurmës, e po ashtu edhe te dridhjeve, ndërsa sa i përket dritës nxehtësisë dhe rrezatimit kompania ka mjaftueshëm drite dhe nxehtësi. Kompania nuk ka pasur asnjëherë

probleme me mjedis apo inspektorat mjedisor, kompania gjithashtu nuk bene ndotje as nga mbeturinat komunale sepse ato i ruan ne kontejner te posaçëm deri sa kompania e licencuar vjen ti merr ato dhe se nuk bën hedhjen e tyre ne ambient.

- d) Kompania “DSG HOLDING” Sh.p.k. ka marrur te gjitha masat për ruajtjen e shëndetit te njeriut, për arsye se objekti i kompanisë është shume i qëndrueshëm dhe mund ti përballoj fatkeqësive natyrore siç janë tërmetet, erërat dhe vërshimet, ndërsa sa i përket zjarrit kompania ka marre te gjitha masat për fikjen e zjarrit ku ka te ndërtuar hidrantët e ujit si dhe aparatet për fikjen e zjarrit. Deri me tani nuk ka pasur ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut.
- e) Sa i përket zonave me rendësi te veçante, fabrika e Ambalazhimit te ujit, nuk rrezikon ndonjë zone te veçante apo burim natyror.
- f) Ky projekt nuk ka ndikim te madh ne natyre për sa i përket gazrave serrë, për arsye se kamionët dhe te gjitha makineritë qe përdoren brenda ne fabrike janë me gazra me te larte se Euro 4 te cilat lejohen për përdorim dhe se nuk kanë ndikim ne cënueshmerine e projektit dhe po ashtu nuk kane ndikim ne ndryshime klimatike.
- g) Pasojat e mundshme mund te vijnë nga derdhia e karburanteve te makinave, nga sistemi elektro-energjetik, sa i përket pasojave ndërkufitare nuk ka fare pasoja sepse është po thuajse ne qendër te komunës dhe nuk bene kurrfarë ndotje qe te ndikoj ne komunat fqinje. Pasojat pozitive janë ato qe kompania ne fjale pritet te punësohen te paktën 10 puntor sa per fillim dhe pastaj me rritjen e kërkesave rritet dhe numri i punëtorëve te cilët do ti kane kushtet shume te mira. Ndërsa pasoja negative nuk ka fare.
- h) Për sa i përket mbrojtjes se mjedisit kompania ka marrur te gjitha masat për mbrojtjen e Ajrit (nuk përdoren makineri te vjetra), ujit (shkarkohet ne kanalizimin e fshatit) dhe tokës (nuk kemi rrjedhje te derivateve ne tokë).

7. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat te cilat janë përdorur për Vlerësimin e pasojave Mjedisore paraqiten si me poshtë:

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike menaxhimi i trajtimit të çështjeve mjedisore. Si e tillë, ajo plotëson dhe përforcon një metodë sistematike në menaxhimin e përgjithshëm të një organizate; dhe organizatat me një menaxhim të shëndoshë përgjithësisht kanë një performancë më të mirë përmes një metode proaktive dhe të përgjithshme për zgjidhjen e aspekteve të veprimeve të saj. E kundërta e menaxhimit sistematik është reagimi ndaj vendimeve të marra rregullimi i gjërave kur ato prishen, të kuptuarit se si duhet vepruar kur ka një kërcënim të gjobave dhe padive ose kur përballesh nga konkurrentë

më të efektshëm. Marrja e vendimeve të shpejta rrallë është një menaxhim i mirë. Në disa raste, organizatat i përfshijnë Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit, sepse ata tashmë e kishin një sistem të mirë menaxhimi; në raste të tjera Sistemi i Menaxhimit Mjedisor çon në një menaxhim të përgjithshëm më të mirë duke hapur rrugën përmirësimit të përgjithshëm të veprimeve, dhe futjen e praktikave të mira të menaxhimit aty ku ato nuk kanë ekzistuar më parë. Në rastin e Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit, ka edhe përfitime të veçanta: kursime në kosto, përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme, përmirësimi i marrëdhënieve me autoritetet, zvogëlimi i rrezikut në aspektin e detyrimeve mjedisore, përmirësimi i motivimit të punonjësve, përmirësimi i shëndetit në punë dhe një performancë më të mirë mjedisore.

Kursime në kosto: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kërkojnë praktika për parandalimin e ndotjes, që në mjaft organizata sjellin kursime financiare. Në një fabrikë prodhimi pa aktivitete të mëparshme mjedisore, shpesh gjysma e ndotjes mund të parandalohet me investime të vogla dhe me procese të thjeshta përmirësimi ose me një qeverisje të mirë të brendshme. Në vendet Evropiane, tarifat e nënshtruara të shkarkimit dhe tarifat për hedhjen e mbeturinave janë shpesh herë mjaft më të larta se kostoja e aktiviteteve për parandalimin e ndotjes, në këtë mënyrë gjëndërohen përfitime financiare. Gjithashtu veprimtaritë dhe teknologjitë për të përmirësuar rendimentin e energjisë, si sistemet efektive të ndriçimit apo gjeneratorët elektrike dhe pompat shpesh janë me leverdi. Kjo do të thotë se ato gjenerojnë kursime në kosto.

Zvogëlimi i rrezikut: Menaxhimi sistematik i rrezikut është një detyrë e përgjithshme për çdo organizatë, dhe një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të mbështetë menaxhimin e rreziqeve nga dhe drejt mjedisit, që mund të parashtrojnë një rrezik për të ardhmen e vetë organizatës, p.sh. nëpërmjet emetimeve që nuk janë të pranueshme për mjedisin ose aksidente që mund të çojnë në detyrime mjedisore ose dëmtim të reputacionit. Shqyrtimi fillestar mjedisor është gjithashtu një vlerësim i rreziqeve mjedisore, duke qenë se ai vlerëson pasojat dhe mundësinë e ndikimeve mjedisore. Plani i veprimit që rrjedh, dhe aktivitetet e tjera të zbatimit të sigurojnë mjetet për të menaxhuar këto rreziqe, duke u përpjekur në reduktimin si të mundësive të tyre dhe të efekteve negative.

Përputhje me legjislacionin: Organizatat në Ballkan dhe Evropë, kryesisht ato të përfshira në prodhim, veprojnë në mjedis mjaft të rregulluar: ata duhet të pajtohen më një legjislacion mjedisor të komplikuar. Gjithmonë e më shumë, aktivitetet e rrezikshme për mjedisin kanë nevojë për leje mjedisore. Për një organizatë, pajtimi me legjislacionin mjedisor është një detyrë e rëndësishme, meqenëse mos-pajtimi mund të çojë në detyrime dhe pasoja ligjore për

përfaqësuesit ligjorë të organizatës – drejtuesit e lartë të saj. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë ligjore, pasi ato sigurojnë një bazë për identifikimin e legjislacionit të përshtatshëm, kërkesat e zbatueshme dhe kontrollon përputhshmërinë brenda organizatës. Kjo metodë sistematike me përputhshmërinë ligjore ndihmon gjithashtu në përmirësimin e marrëdhënieve të organizatës me autoritet mjedisore.

Marrëdhënie më të mira me publikun e gjerë: Aktivitetet e organizatave jo qeveritare dhe protestat publike kundër projekteve që mund të dëmtojnë mjedisin, tregojnë se ndryshimet në shoqëri po ndodhin në nivel global dhe lokal. Konventa Aarhus ndihmon publikun që të ketë një zë në vendimet politike që prekin cilësinë e këtij mjedisi, i ofron publikut akses të lirë në informacion, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e gjyqimit për çështjet mjedisore. “Palët e interesuara” si rezidentë, grupet e interesit, media, klientët dhe çdo lloj grupi tjetër apo individ me interes në një çështje, janë tani pjesë e realitetit të një organizate, dhe mënyra më e mirë për tu sjellë me ta është fitimi i besimit nëpërmjet një informimi dhe komunikimi të rregullt dhe të besuar. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ju ndihmon në përgatitjen e të dhënave dhe informacionit që ju duhen për këtë proces komunikimi, ndërsa certifikatat dhe raportimi i rregullt do të mbështesin procesin e fitimit të besimit.

Përmirësimi i motivimit të punonjësve: Një nga rezultatet më të paparashikuara në anketat e organizatave që kanë zbatuar Sistemet e Menaxhimit Mjedisor është përmirësimi i motivimit të punonjësve. Punonjësit përfitojnë drejtpërdrejt nga efektet anësore si përmirësim i shëndeti në punë dhe i kushteve të sigurisë, por gjithashtu ata kujdesen për mjedisin.

Përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme: Ka dy tipe kryesore presionesh që do të ndryshojnë tregjet e së ardhmes: Së pari, kufizimet e botës natyrore – çështje si ngrohja globale, pamjaftueshmëria e ujit dhe humbja e biodiversitetit- do të ndrydhin veprimet e bizneseve. Së dyti, bizneset përballen me një spektër në rritje të klientëve që janë të shqetësuar për mjedisin. Ato biznese që përballen më mirë dhe që i gjejnë një zgjidhje këtyre sfidave, do të mundin konkurrentët e tyre. Duke rritur ndërgjegjësimin mjedisor brenda organizatës suaj, një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të ndihmojë në zbatimin e hapave të nevojshme si eko-projekti, në mënyrë që të zhvillohen procese dhe produkte që do të jenë të përshtatshme për tregjet e së nesërme, të cilat do të jenë më të ndërgjegjësuar për mjedisin.

8. PERSHKRIMI I MASAVE

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha masat që duhet marrur kompania për t'ju shmangur, parandaluar, zvogëluar apo mënjeluar pasojat negative në Mjedis:

8.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga Fabrika e ambalazhimit të ujit “SIBORA”, nga kompania “DSG HOLDING” L.L.C., Fshati Gremnik Komuna e Klines, duhet që operatori në fjalë të mirëmbaje dhe ujite në mënyrë të vazhdueshme sipërfaqen e tokës ku operon në mënyrë që të mos krijohet pluhuri, duhet të i kushtohet rëndësi edhe pajisjeve mekanike që përdoren gjatë procesit të mbushjes së shisheve me ujë dhe transportit të tyre, makinat që përdoren për transport që të mos të lirojnë gazra e me këtë të ndotet ajri mirëpo ato të mirëmbahen në mënyrë të rregullt, të mos lihen të ndezura pa nevojë e të lirojnë gazra. Mirëpo nga procesi i ambalazhimit të ujit nga fabrika në fjalë mund të themi lirisht se ndotja e ajrit është minimale kur kemi parasysh sasia e madhe e ujit që përdoret për gjatë këtij procesi.

Megjithatë gjatë operimit do të merren masat:

- Mirëmbajtje e hapësirës së fabrikës ku operon kompania DSG HOLDING,
- Kujdesi maksimal gjatë procesit të transportit, mbushjes dhe përgatitjes së produktit final para tregtimit,
- Mirëmbajtjen e rregullt të makinerisë së punës dhe makinerisë lëvizëse-motorike.

8.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe më lart nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikime në tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së parcelës ku operon fabrika për Ambalazhimin e ujit, “DSG HOLDING” L.L.C., është hapësirë e gjelbëruar dhe pjesa tjetër ku ka lëvizje motorike është e shtruar me kubza. Ndotja e ujit mund të vijë nga larja e pajisjeve dhe mjeteve motorike për transportim të ujit, mirëpo fabrika në fjalë këto ujëra nga procesi i larjes i grumbullon dhe përmes sistemit të gypave shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit.. Në fakt, në afërsi të hapësirës ku është duke ushtruar aktivitetin e saj fabrika për ambalazhimin e ujit natyral nuk ka burime sipërfaqësore të ujit të cilat përdoren për pije dhe burime të ujërave, ndërsa ujëra nëntokësore shfrytëzohen për burime vetanake dhe nuk dëmtohen nga aktivitetet e kësaj veprimtarie dhe me këtë mund të kolloidohet se ndikimet do të jenë minimale.

Për minimizimin e ndikimeve do të ndërmerren masat si në vijim:

- Fabrika për ambalazhimin e ujit, ka planifikuar ndërtimin e një impianti të ri për trajtimin e ujit, ku ujërat që përdoren për pastrimin e pajisjeve si dhe ujerat nga punëtoret të para trajtohen para se të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit.
- Masa e rëndësishme për zvogëlim do të jetë edhe grumbullimi dhe trajtimi i ujerave nga reshjet atmosferike si dhe mbledhjen e ujerave të shkarkuar nga të gjitha objektet e fabrikës dhe dërgimi i tyre në impiant për trajtim.
- Gjithashtu me qëllim të evitimit të ndikimeve tjera në ujëra, investitori duhet dhe do të zbatojë në përpikëri të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative për mbrojtjen e ujerave sipërfaqësore, ujerave nëntokësore dhe burimeve tjera të ujit.

8.3 Masat për mbrojtje nga zhurma

Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral dhe mineral, “DSG HOLDINGO” L.L.C, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij nuk shkakton zhurmë ose një zhurmë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku ushtron aktivitetin e tij fabrika Ambalazhim të ujit, është afër rrugës kryesore Kline - Gjakovë , prandaj zhurma që krijohet nga fabrika është thuajse me e vogël se ajo e komunikacionit, prandaj zhurma nuk paraqet ndonjë shqetësim të madh. Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rëndësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.

8.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcela në lokacionin në të cilën fabrika për ambalazhimin e ujit natyral dhe mineral, e ushtron aktivitetin e vet, siç është cekur edhe më lart është mjaft e përshtatshme për këtë veprimtari ngase gjenden në një zonë të qetë dhe ka ndërtim, prandaj dhe nuk pritet ndikim negativ në peizazh, florë dhe faunë e vendbanimit në fjalë dhe regjionit në përgjithësi.

8.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin e saj fabrika e ambalazhimit të ujit “DSG HOLDING” LLC, është në fshatin Gllamnik, Kline, të njëjtit nuk kanë pasur deri më tani ndonjë ankese rrethë aktivitetit të fabrikës së ambalazhimit, por investitori ka pasur vetëm bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal të zonës dhe do të

njofton ata me kohe për te gjitha aktivitetet e mundshme që mund të ndikojnë në vendbanim dhe në popullatën lokale gjatë aktivitetit të kompanisë.

8.6 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktivitetëve të kësaj fabrike mund të vlerësohen si raste të izoluara. Për te mos ardhur deri te ndonjë aksidenti eventual investitori i fabrika për ambalazhimin e ujit, “DSG HOLDINGO” L.L.C. duhet që të merren të gjitha masat adekuate paraprakisht. Rreziku me i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet elektrike të fabrikës.

8.7 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial të vogla për ndotjen e kualiteti të ajrit.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë erërave të forta të cilat mund të bartin pluhurin nga sipërfaqja e parcelës, si dhe nga ndikimi nga djegia e derivateve në makineria punuese dhe ato lëvizëse, lënda djegëse për ngrohje etj.	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të parcelës, Mirëmbajtja e makinerisë punuese, Mirëmbajtja e makinerisë lëvizëse dhe mos ndezja e motorëve të tyre pa nevojë, Përdorja e lëndës ngrohës miqësore me ambientin etj.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston të dheu dhe ujërat nëntokësore	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i keq menaxhimit të ujërave të shkarkuara nga procesi i pastrimit dhe pastrimit të pajisjeve që përdoren për ambalazhim.	Fabrika për ambalazhim “DSG HOLDINGO” L.L.C, nuk e ka të ndërtuar impiantin për trajtimin ujërave ndotura të shkarkuara nga procesi i ambalazhimit të ujit
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e	Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në zhdukje.	Sipërfaqja ku është ndërtuar Fabrika për ambalazhim të ujit “DSG HOLDINGO” L.L.C K., është sipërfaqe e vogël, dhe	Me që në vendin për ambalazhimin e ujit, është zonë rurale e cila është e ndërtuar me shumë shtëpi dhe shumë biznese të vogëla nuk ka florë dhe faunë shumë të zhvilluar

mbrojtura të natyrës)		kjo nuk mund të ndikoj në shkallen e mikrosistemit.	dhe për rrethe ne rajonin në përgjithësi, rriten dhe zhvillohen llojet e ndryshme të florës dhe faunës. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikim është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
Zhurma	Potencial minimal	Nga ky aktivitet për Fabrikën për amabalazhimin e ujit “DSG HOLDINGO” L.L.C ka potenciale te vogla te shkaktimit te zhurmë	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim te madh në ambientin jashtëm.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës se Fabrika për ambalazhimin e ujit “DSG HOLDINGO” L.L.C për rreth tij	Te gjitha pajisjet te cilat mund te kenë ndikime ne shëndetin e qytetareve do tu kushtohet rëndësi e veçan ne mirëmbajtjen e tyre.

8.8 Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit te Fabrikës për ambalazhimin e ujit nga kompania “DSG HOLDINGO” L.L.C., krijohen mbeturinat po thuaje se fare pake gjate procesit teknologjik te prodhimit dhe atë ne mbetje te ambalazhes dhe plastikëve, pra kryesisht mbeturina te riciklueshme si dhe përjashtim mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit te punës ne Fabrikë. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikat e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave Fabrikën për ambalazhim te ujit natyral dhe mineral kompania “DSG HOLDINGO” L.L.C, ka marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave nga Komuna e Klinës.

Për mbetje e mundshme te këtij aktiviteti, zgjidhja është si ne vijim:

- Mbeturinat e riciklueshme do te grumbullohen dhe do te dërgohen ose do te merren nga kompanitë te cilat merren me riciklim,
- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë

adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina, ndërsa

- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do të trajtohen komfor legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.



Figura 14 Kontejnerët e mbeturinave te ndara

9. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me Fabrikën ambalazhimit të ujit nuk kemi fare rrezik, mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djegë ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi - Në bazë të gjendjes faktike në terren, pasi që ky aktivitet nuk paraqet tryzni mjedisore (nuk parashihet përdorim të ndonjë teknologjie po parashihet përpunim i produkteve kimikale) monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komfor ligjeve dhe të njoftohen organet kompetent .

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhimet, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e te

gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore e cila lëshohet nga MMPHI.

11. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të arrijmë në një përfundim si në vijim:

Fabrika e ujit të ambalazhuar “SIBORA” nga kompania “DSG HOLDINGO” L.L.C, është e ndërtuar në vitet e mëhershme e cila është shfrytëzuar si pike distribuimi për produkte tjera por tani nga ky vit (2023) kompania ka menduar që të fillojë me ambalazhimin e ujit natyral dhe mineral për të cilin është rritur kërkesa në vendin tone dhe që ushtron aktivitetin e saj dhe është në interes;

- të vet investitorit për të përmirësuar kushte e punës, për të ngritur sasinë e ambalazhimit;
- në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe
- në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti me të menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe produkte me cilësi të sigurt.

Në rast se Fabrika për ambalazhimin e ujit nga kompania “DSG HOLDINGO” L.L.C do të mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, kjo fabrike konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik.

- Duke u bazuar në natyrën e Punës së fabrikës dhe aktivitetit të sajë, vendndodhjen e Fabrikës, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastruktura (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit “DSG HOLDINGO” L.L.C., Gremnik Komuna Klinë.

12. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- [Microsoft Word - Propozimi 26 03 13 \(rks-gov.net\)](#)
- [DSG holding – Company \(dsgholding-ks.com\)](#)
- [HARTA-ZONALE-E-KUMUNES-SE-KLINES.pdf \(rks-gov.net\)](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP \(rks-gov.net\)](#)
- [OpenStreetMap](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)

13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT:**TABELA E KOST – BENEFITIT TE INVESTIMIT NE , HANGARIN E LINJËS SË PRODJIMIT TË UJIT**

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Objekti montazh	10,000.00 €
2.	Pllaka e armuar	8,000.00 €
3.	Kulmi nga konstruksioni i çelikut	7,000.00 €
4.	Makina për fryrjen e shishes	25,000.00€
5.	Makina për filtrimin e ujit	30,000.00
6.	Makina për etiketim	22,000.00
7.	Makina për mbushje te shisheve	21,000.00
8.	Makina për paketim	24,000.00
9.	Makina për dezinfektim	23,000.00
Shuma totali investive:		170.000.00 €

“ DSG HOLDING:L.L.C.

“DSG HOLLDING” L.L.C
